



VENDIMËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 DOLLIKA JE PRAVNOSNAŽNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROŠEVAC

P. nr. 1645/15

**NË EMËR TË POPULLIT**

Më  
 Dana

11. 12. 2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL,** me Gjyqtarin e vetëm gjykues Mustaf Tahiri

dhe bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së”, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP. I.nr. 200/13 e datës 04.03.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 01.06.2017, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini dhe të pandehurit [REDACTED], të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 07.06.2017, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri [REDACTED], nga [REDACTED] rr ” [REDACTED] ” rrugica [REDACTED] [REDACTED] te [REDACTED], i lindur më [REDACTED], në [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal [REDACTED].

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Me datë 08.09.2013 rreth orës 00.00, në fshatin Davidovc, K. Shtime, në lokalin “Dani”, pronë e të dëmtuarit [REDACTED], në bashkëkryerje së bashku me të miturin [REDACTED] dhe [REDACTED], me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit të i sjellin përfitime pasurore të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës dhe me një mjet të përshtatshëm- kacavit kanë hapur derën e lokalit të të dëmtuarit kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marrë cigare të llojeve të ndryshme , 5 copë Lyckystrike e kaltërt, 7 copa West të bardh, 6 copa Prestige, 7 copa Ronhill të bardhë, 8 copa Boss dhe gjëra ushqimore të ndryshme disa popkek, kifile 7 days, 24 kifile me firmën Carat në vlerë të përgjithshëm rreth 50 euro, si dhe kanë dëmtuar derën e lokalit e lokalit në vlerë prej 10 euro,

**me çka ka kryer në bashkëkryerje veprën penale “vjedhje e rëndë” nga neni 327 par. 1 nënpar 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,**

Andaj Gjykata në bazë nenit 327 par.1 lidhur me nenin 31 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49, 51, 64, 65, 75,76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

## G J Y K O N

**DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 400/KATËRQIND/€, dënim të cilin është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

**DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/NJË/ VIT E 6 /GJASHTË/ MUAJ, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën prej 2/DY/VITEVE pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale.**

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën e evidentuar PP.I.nr. 200/13 e datës 04.03.2014, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje “vjedhja e rëndë” nga neni 327 par.1 nënpar 1 pika 2.7 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini, para leximit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale ashtu që duhet të jetë “me çka ka kryer veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 01.06.2017, në të cilën shqyrtim fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke shprehur pendimin për veprën penale të kryer si dhe duke premtuar se nuk do të përsërisin vepra të kësaj natyre.

Prokurori me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin pasi që një pranim i tillë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit fotografitë si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo faktike.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjykata, konform nenit 248 par. 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje “vjedhje e rëndë” nga neni 327 par.1 nënpar.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64, 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, deri më tani nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, kurse në rastin konkret nuk gjeti rrethanë rënduese pos që vlerësoi peshën konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e caktuar, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuara është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit e që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen

(preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së, I dëmtuari [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] K. [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, pasi që të dhënat e mbledhura gjatë procedurës penale nuk kanë paraqitur bazë për të vendosur në mënyrë të plotë e as të pjesërishtme për kërkesën pasuroro-juridike.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20/njëzetë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM,**

**P.nr. 1645/15 datë 07.06.2017.**


**B. Profesionale,**

**Mirlinda Bytyqi Rexhepi**



**Gjyqtari,**

**Mustaf Tahiri**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.